

DOKUMENTACIONI TEKNIK PËR KRYERJEN E OPONENCËS SË AKT EKSPERTIZËS SË

THELLUAR

1. Analiza e thelluar
2. Dokumentimin gjeometrik
3. Studimin gjeologjik
4. Studimin sizmik
5. Raportin topografik
6. Katalogimin e dëmtimeve
7. Prova laboratorike të materialeve
8. Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse
9. Preventivi I punimeve + analiza cmimesh
10. Metodologjia e punimeve
11. Licensat e projektueseve + deklaratat e përgjegjësishë profesionale

Analiza e thelluar duhet të përmbaj :

- Gjendjen ekzistuese
- Përditësimin gjeometrik të strukturës;
- Evidentimin dhe katalogimin e dëmtimeve;
- Prova laboratorike;
- Të dhëna gjeologjike, topografike dhe sizmike;
- Analizën lineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, të përshtatshme për tipin e strukturës. Ngarkimi sizmik të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005 ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të;
- Analizën jolineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, sipas njërës nga metodat e përshtatshme për tipin e strukturës që po analizohet;
- Konkluzionin për performancën e godinës, sipas metodologjisë bazuar në standardin shqiptar për sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me standardin shqiptar për sizmicitetin;
- Rekomandimet për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me to;
- Analizën e kostos